

Çka është Shtëpia për strehim të fshehtë („Schlupfhuus“)?

Shtëpia për strehim të fshehtë është një insitucion në qytetin e Cyrihut, që përndryshe është e hapur natë e ditë për të gjithë të rinjtë dhe të rejat e moshës 13 deri në 18 vjeçare. Në shtëpinë e strehimit dëgjoheni, këshilloheni dhe ju ofrohet strehim banimi. Krahas kësaj, ekzistonë telefoni për kujdes, këshillimorja si dhe grupi për banim në raste krize. Këtu mund të drejtohen, fëmijët dhe të rinjtë/rejat nëse kanë probleme personale, priteni pa formalitete dhe pa kohë pritjeje për t'u strehuar në shtëpinë e strehimit të fshehtë.

Shtëpia për strehim të fshehtë është themeluar në vitin 1980, edhe atë në formën e një shoqate private, dhe është neutrale në aspektin politik dhe fetar. Qyteti i Cyrihut, kantoni si dhe qeveria e ndihmojnë shtëpinë e strehimit, me anë të subvencioneve. Përveç asaj kemi të mvarur edhe prej ndihmave. Prej vitit 1993, institucioni ynë është i njohur në Kantonin e Cyrihut edhe si Këshillimore për ndihmë personave viktimave.

Kolegjiumi që janë punësuar në Shtëpinë për strehim të fshehtë, është një përzierje e pesonave me prejardhe interkulturore. Të gjitha tetë gratë dhe tre meshkujt janë me pregaditje profesionale nga lamia socialo-pedagogjike, psikologjike apo si punëtorë/e social, dhe njiherit kanë mjaft përvojë pune me fëmijët dhe të rinjtë/rejat.

Kush drejtohet në Shtëpinë për strehim të fshehtë?

Fëmijët dhe të rinjtë/rejat, të cilët drejtohen për ndihmë, në të shumtën e rasteve kanë probleme gati të ngjajshme. Pamvarësisht prej prejardhjes së tyre, të gjithë të rinjtë/rejat kanë gati po të njejtat probleme në fazën e procesit të ndarjes/ mëvetsimit, të njejtat dëshira, apo aspirata në që ndonjëherë sjellin konflikte dhe mosmarrëveshje me prindërit. Ato për shembull, kërkojnë më tepër liri individuale në përditshmëri, kërkojnë të kenë më tepër të drejtë në marrjen e vendimeve kur ka të bënë me individin e tyre personal apo në sferën familjare, kërkojnë më shumë liri mendimi për marrjene e vendimeve të ardhmëris së tyre etj. Prindërit nga ana tjetër mundohen që vlerat dhe traditat e veta t'ua përcjellin edhe fëmijëve të tyre. Shpesh prindërit kanë frigë se vajza apo djali i tyre „do të zvicanizohet“ apo do të bie nën ndikimin dhe influencën negative të rrethit. reja këto sjellin deri në mosmarrëveshje, ndonjëherë edhe deri tek ushtrimi i dhunës, e këto rrethana ndonjëherë e sjellin tërë familjen deri në një krizë permanente dhe të padurushme. Tek të rinjtë/rejat mund të sjellë deri në probleme në shkollë, në vendin e punës, apo vështirësi në raportet me të tjerët, humbje të perspektivës dhe deri në mvarshmërinë prej narkotikëve. Sa më shumë të jetë thelluar kriza, aq më vështirë është që të gjendet zgjidhje apo rrugëdalje prej situatës në kuadër të familjes. Me ndihmën e personave profesional, ekzistonë mundësia, që të gjindet zgjidhje e problemit për të rinjtë/rejat apo për familjen e tyre.

Ne punëtorët dhe punëtorët e shtëpisë së strehimit të fshehtë, punën tonë e kuptojmë si ushtrim dhe ofrim të ndihmës në rastin kur fëmijët apo të rinjtë/rejat kanë probleme. Por, në punën tonë është njiherit me rëndësi , që t'i kuptojmë edhe prindërit e tyre, kulturën, kërkesat apo brengat e tyre, ashtu që njiherit bashkarisht të mundohemi të gjejmë zgjidhje realiste, të arsyeshme dhe të shëndosha për fëmijën e tyre.

Çka ofron Shtëpia për strehim të fshehtë?

Telefoni i kujdesit/ Telefoni i ndihmës 043 268 22 66 për fëmijë dhe të rinjë/të reja

Fëmijët dhe të rinjtë/rejat, kanë mundësi që në çdo kohë të thirrin në numrin e Telefonit të kujdesit në shtëpinë e strehimit apo nën numrin 043 268 22 66, telefonin për ndihmë. Thirrësi/thirrësja, nëse dëshironë mund të mbesi edhe anonim/e. Nëpërmjet telefonit bëhet sqarimi i problemit që e mundon fëmijën apo të riun/ të renë. Ndoshta doni thjesht vetëm të bisedoni me dikushin që do t'ju dëgjonë apo ndoshta keni edhe ndonjë problem dhe kërkonin ndihmë konkrete.

Këshillimorja

Sa, i përket këshillimit, fëmijët dhe të rinjtë/reja si dhe prindërit e tyre apo personat e afërm mund të drejtohen pa paralajmërim në shtëpinë e strehimit. Këshillimi mund të jetë i njihershëm apo edhe i disahershëm. Kjo ndihmë apo bisedë këshillimi ofrohet në situatat kur rasti nuk mund të sqarohet nëpërmjet telefonit, apo në rastet kur janë të involvuar disa persona dhe të gjithë ato duhet të inkorporohen në bisedën e këshillimit që ofrohet. Këshilltari/ja ofron bisedë këshillimi të veçantë për personin në fjalë apo këshillim për tërë familjen. Nëse ai/ajo e sheh të nevojshme merrë kontakt edhe Këshillimoret e specializuara për problemin

e specifike apo me institucionet tjera (p.sh. Sekretariatit për të rinj/reja), apo dhe ofron ndihmë në problemet akute, p.sh. ndihmë në kërkimin e një vendi të punës, sqarimin e situatës së banimit etj.

Grupi i banimit

Grupi i banimit në shtëpinë e strehimit, ofron banim për 8 të rinj/reja, të moshës 13 deri në 18 vjeçare, por kjo është vetëm një mundësi e përkohshme banimi deri në 3 muaj. Një banim i përkohshëm në shtëpinë e strehimit, do të ishte adekuate në rastet kur të rinjtë/rejat nuk mund të kuptohen më aspak me prindërit apo kujdestarin e tyre, dhe si pasojë këto mosmarrëveshje sjellin deri tek një ngarkesë e madhe psikike apo deri tek ushtrimi i dhunës fizike. Bisedat e rregullta në veçanti me individin apo edhe bisedat familjare janë pjesë e kujdesit që ofrohet, pra krahas këshillimit të rregullt dhe përkujdesjes. Qëllimi i banimit në shtëpinë e strehimit është që, në ndërkohë të zbutet ngarkesa që e ka kapluar të riun/renë si dhe të relaksohet ambienti ku ai/ajo jetonë, dhe njihërit që të menjahet eskalimi i konfliktit apo të zbutet situata akute e krizës. Në ndërkohë bisedohet mbi marrëdhëniet e tij/saj me personat tjerë të familjes, dhe bashkarisht kërkohen mundësitë e zgjidhjes së problemit/eve.

Ne i pranojmë në shtëpinë e banimit, të rinjtë/rejat të cilët drejtohen me vetë vullnetin e vetë në shtëpinë e banimit të fshehtë. Ata/ato në kohën kur janë duke banuar aty, duhet që t'u përmbahen dhe t'ë respektojnë rregulloren tonë shtëpiake, dhe të jenë të motivuar që të konfrontohen me situatën e tyre jetësore.

Si e gjejnë të rinjtë/ të rejat Shtëpinë e strehimi të fshehtë?

Shtëpia për strehim të fshehtë, është si tek shkollat ashtu edhe tek institucionet e shumta në tërë kantonin veç e njohur. Bashkëpunëtorët/et tona e prezantojnë institucionin tonë nëpër shkolla të ndryshme, japin intervista nëpër gazeta, radio apo televizion. Të rinjtë/rejat dëgjojnë për institucionin tonë edhe prej moshatarëve të tyre, prej mësuesëve/mësuesve apo prej përgjegjësit të tyre në vendin ku janë duke bërë zejen. Shtëpia e strehimit të fshehtë, duhet kuptuar si institucion preventiv. Bashkëpunëtorët/et tënë mundohen që bashkë me të riun/të renë të gjejnë zgjidhje të problemeve dhe perspektivave për jetën e mëtejme të tyre.